



Programi

Në 14 Mars gëzojmë në bulevardin e Tiranës, duke filluar nga ora 10:00 e mëngjesit.

Muzikë, art, lojëra dhe argëtim!

Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore

Koncert me këngë e valle të trevave të ndryshme shqiptare.

Sheshi përpara TKOB

Ora : 10:00 -11:00

Teatri Kombëtar i Kukullave

Shfaqja :“Kush është fajtori”

Ndodh tek Parku Rinia (në hapësirën përpara Tajvanit, perballe GKA)

Ora 11:00- 13:00

Cirku Kombëtar i Tiranës

Ora: 10.00 - 12.00

Ndodh tek Parku Rinia.

Aktivitete sportive

1. Aktiviteti “Atletik kids”

Lojëra zbavitëse me fëmijë të shkollave fillore të Tiranës, organizuar nga Federata Shqiptare e Atletikës, të cilat do të realizohen në “Parkun Rinia”, në hapësirën pranë urës së madhe të Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” nga ora 9:30 deri në 12:00;

2. Demonstrime të sportit të Karatesë

Organizuar nga Federata Shqiptare e Karatesë, me fëmijë të grup moshave të ndryshme të cilat do të realizohen në “Parkun Rinia”, në hapësirën pranë Monumentit të Pavarësisë ora 9:30 deri në 12:00;

3. Demonstrime të sportit të Judos

Organizuar nga Federata Shqiptare e Judos, me fëmijë të grup moshave të ndryshme të cilat do të realizohen në një nga hapsirat e “Parkut Rinia”, në hapësirën pranë Monumentit të Pavarësisë ora 9:30 deri në 12:00;

4. Demonstrime të dancit sportiv

Organizuar nga Federata Shqiptare e Dancit Sportiv, me fëmijë të grup moshave të ndryshme të cilat do të zhvillohen tek ura e madhe e Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe tek sheshi i tre vëllezërve “Frashëri” (pranë kullave binjake), nga ora 10:00 deri në 12:00.

5. Simultane shahu

Me fëmijë të shkollave 9-vjeçare. Tek ura e madhe e bulevardit.

Panairi i Artizanatit

Agjencia publike “Nxitja e Biznesit Social” organizon në prag të ditës së verës, Panairin e Artizanatit, Tiranë. Ky Panair do të organizohet te sheshi para Piramidës.

Ora 10:00-16:00